

Tirane, me date 01/03/2025

Akt - Themelimi i shoqerise me pergjesi te kufizuar:
“Vian Pharma Albania 2022”

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise, ne Ligjin Nr. 7512 date 10.08.1991 “Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit”, te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, “ Per shoqerite tregtare” dhe te ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 “Per Q.K.B” dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare, me vullnetin tone te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi, sot me date 01/03/2025, une ortaku i vetem i shoqerise Adriana Alike lindur ne Tepelenë dhe banuese ne Tirane krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **“Vian Pharma Albania 2022” Sh.p.k** me akt themelimi si vijon :

Formulimi

Neni 1

Une, **Adriana Alike**, e bija e Ylli dhe Vjollca Alike, e datelindjes 01.01.1983, lindur ne Tepelene dhe banuese ne Tirane, madhore dhe e afte per te kryer funksione juridike, e pajisur me karte identiteti me numer 036534563 dhe numer personal I36001187L me vullnetin tim te lire, vendosa te krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar si me poshte vijon:

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur **“Vian Pharma Albania 2022” shpk**. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues .

Selia e Shoqerise

Neni 2

Selia e shoqerise tregtare private **“Vian Pharma Albania 2022” shpk** do te jete me adrese: ne Rruga Margarita Tutulani, Nr. Pasurise 7/636-N3(Njësi), Zk. 8270, Tirane.



Shoqëria mund të ndryshojë seline e saj , të hapë zyra perfaqësuese, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë .

Objektivi I Veprimtarisë

Neni 3

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e mëposhtme:

Shoqëria ka si objekt të saj ushtrimin e të gjitha aktiviteteve të lejuara për një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me fokus kryesor në:

- a) Tregti e produkteve farmaceutike, pajisjeve mjekësore dhe artikujve për kujdesin shëndetësor.
- b) Importin dhe eksportin e produkteve farmaceutike, kozmetike, suplementeve ushqimore, pajisjeve mjekësore dhe ortopedike.
- c) Shitjen e produkteve dermokozmetike, materialeve mjekësore, artikujve për fëmijë dhe integratorëve ushqimorë.

Për realizimin e objektivave të saj, shoqëria mund të bashkëpunojë me kompani dhe sipërmarrje të tjera, brenda dhe jashtë vendit, që zhvillojnë aktivitete të ngjashme ose të lidhura me fushën e saj. Gjithashtu, mund të ndërmarrë çdo veprimtari ndihmëse ose plotësuese që mbështet dhe lehtëson përmbushjen e misionit të saj tregtar.

Kohezgjatja e Shoqërisë

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë pa afat, me mundësinë e zgjatjes apo të shkurtimit të afateve, të ndryshojë veprimtarinë, emertimin, seline, objektin e veprimtarisë sipas vendimit të ortakëve të shoqërisë.

Kapitali I Shoqërisë

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 500,000 leke (peseqind mijë leke). I përbërë nga kontributi i ortakëve themelues i Adriana Alikës, e ndarë në 1 kutotë me vlerë 500,000 leke e cila është në masën 100% e kapitalit. Kapitali themelues mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrin ortakët, por asnjëherë nuk mund të pakesohet në nivelin e kapitalit themeltar fillestar të shoqërisë .



Kapitali eshte teresisht i shlyeshem e i nenshkrueshem.
Çdo kuote i takon e drejta e votes.

Drejtimi I Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratorja Adriana Alike e bija e Ylli dhe Vjollca Alike, e datelindjes 25.06.2024 lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhore dhe e afte per te kryer funksione juridike, i pajisur me karte identiteti me numer 036534563 dhe numer personal I36001187L, e cila do te jete dhe perfaqesuesja ligjore e saj .

Ajo eshte perfaqesuesja e Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj .

Çdo kontrate do te kryhet prej saj dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posacme .

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve.

Neni 8

Ortaket themelues kane te drejte te emerojne dhe administratore te tjere. Kane te drejte te caktoje financiere, likuidatore per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake .

Neni 9


Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Tirane .

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin ne te .

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Krijimin e Shoqerive Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .



Neni 12

Akti I themelimit u perpilua ne kater kopje me nga kater flete secila, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise **“Vian Pharma Albania 2022” shpk.**

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaket e shoqerise.

Ortaku themelues e shoqerise “Vian Pharma Albania 2022” shpk

Adriana Alike

Adriana Alike

